



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E enjte, 9 prill 2015

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 13, datë 9.4.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”.....	2313
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 13, datë 1.4.2015	Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe lirimit nga puna të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional.....	2314
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 4.3.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Koxheri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Koxherraj”, me fuqi totale 0.62 mw.....	2321
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 4.3.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	2321
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 4.3.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2322
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 4.3.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Electral” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2323
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 4.3.2015	Për licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”, me fuqi 110.54 mW.....	2323
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 4.3.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2324
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 4.3.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2325

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 4.3.2015	Për licencimin e shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	2325
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 4.3.2015	Për licencimin e shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2326
	Vendim i ( <i>shkurtuar</i> ) për shpalljen të vdekur të shtetasit Petraq Kumati (Çami).....	2326
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gramoz Çuman Memushaj.....	2327



## UDHËZIM

Nr. 13, datë 9.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.5.2010 “PËR  
ADMINISTRIMIN DHE  
DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË  
PAJISJEVE FISKALE”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuarra për ofrimin e pajisjeve fiskale”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

## UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 9.1 “Lidhja e dispenserave të karburantit me pajisjen fiskale”, shkronja “c”, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“c. Puna e dispenserit ku është instaluar pajisja fiskale bëhet nën kontrollin KDE, të lidhur sipas skemës dispenser-KDE-pajisje fiskale:

- Dispenseri duhet të punojë vetëm në regjimin automatik, nën kontrollin e sistemit fiskal, më saktë KDE. KDE-ja komunikon me dispenserin sipas protokollit të caktuar, mban të memorizuar numërorin progresiv të dispenserit, duke e freskuar atë pas çdo shitjeje. KDE-ja vuloset në të njëjtat kushte si pajisja fiskale nga tekniku i autorizuar.

- Dispenseri nuk do të vazhdojë të veprojë edhe kur pajisja fiskale pëson defekt të karakterit elektrik apo ndërprerje komunikimi me KDE-në. Derisa dëmtimi të rregullohet, dispenseri duhet të bllokohet, të mos livrojë më lëng.

- Riparimi i pajisjes fiskale duhet të kryhet menjëherë nga shoqëria e autorizuar me të cilën tatimpaguesi ka kontratë mirëmbajtjeje.

- Në rast se shkëputet lidhja midis KDE-së dhe qarkut elektronik të dispenserit, si dhe pajisjes fiskale, dispenseri bllokohet menjëherë.

- KDE-ja kalkulon dhe verifikon vlerat absolute të numërorit pas rilidhjes me numrat e regjistruar në memorien e saj para defektit dhe e dërgon këtë informacion në pajisjen fiskale, duke e printuar automatikisht kuponin tatimor me çmimin e tabelës.

- Tekniku i shoqërisë së autorizuar duhet të paraqesë në librin e mirëmbajtjes të gjitha të dhënat e defektit (data/ora kur filloi dhe mbaroi defekti, si dhe përshkrimi i defektit).

- Në rast mbarimi të letres ose koka e printerit të pajisjes fiskale është e hapur, dispenseri nuk duhet të veprojë.

2. Titulli i pikës 10.1 “Raporti tatimor ditor “Z” në raste pa defekte” zëvendësohet me këtë përmbajtje “10.1 Raporti tatimor ditor “Z””.

3. Pika 10.2 “Raporti tatimor ditor “Z” në rast defekti” shfuqizohet.

4. Në pikën 12.1 “Lidhja e kalimatësve me pajisjen fiskale”, shkronjat “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Dispenseri nuk duhet të vazhdojë të veprojë edhe kur pajisja fiskale pëson difekt të karakterit elektrik apo ndërprerje komunikimi me KDE-në, derisa dëmtimi të rregullohet, dispenseri duhet të bllokohet, të mos livrojë më lëng”.

5. Në pikën 12.2, shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

“d) Menjëherë pas rilidhjes së dispenserit me KDE-në dhe vënies në punë të pajisjes fiskale nën regjimin automatik, KDE verifikon vlerat absolute të numërorit, pas rilidhjes, me numrat e regjistruar në memorien e saj pas difektit dhe e dërgon këtë informacion në pajisjen fiskale, duke printuar automatikisht kuponin tatimor me çmimin e tabelës. KDE-ja mban të memorizuar numërorin progresiv të kalimatësit, duke e regjistruar atë pas çdo shitjeje”.

6. Në pikën 13. 1 bëhet ky ndryshim: “Raporti tatimor “Z”.

7. Pika 13.2 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE  
**Shkëlqim Cani**



**UDHËZIM**  
**Nr. 13, datë 1.4.2015**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE LIRIMIT NGA PUNA TË DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 23, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional janë të njëjta për shkollat e mesme profesionale, drejtoritë rajonale të formimit profesional publik dhe qendrat shumëfunktionale profesionale.

**KREU I**

**KRITERET DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE LIRIMIT NGA DETYRA TË DREJTORIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

I. Shpallja e vendit të lirë për drejtor në institucionet publike ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shpall konkursin për vendin e lirë të drejtorit të institucionit publik ofrues të AFP-së, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e saj të Internetit, si dhe në portalin e AFP-së.

Njoftimi bëhet edhe në një vend të dukshëm në hyrje të institucionit publik ofrues të AFP-së, që ka vendin vakant.

2. Njoftimi përmban këto të dhëna:

- a) pozicioni dhe përshkrimi i përgjithshëm i punës;
- b) kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e veçanta;
- c) dokumentet që duhet të dorëzohen;
- d) afati dhe adresa e dorëzimit të tyre;
- e) data e daljes së rezultateve të kandidatëve që plotësojnë kushtet minimale dhe kriteret e caktuara;

f) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen nëpërmjet intervistës;

g) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;

h) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

3. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mund emërojë përkohësisht një drejtues të institucionit publik ofrues të AFP-së, deri në përfundimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të ri.

II. Kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për kandidatët për drejtor

Kandidati aplikues për drejtor në institucionet publike ofruese të AFP-së duhet të plotësojë:

A. Kërkesa të përgjithshme

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

B. Kërkesa të posaçme

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Master Shkencor (ose të barasvlershme me të), për një nga profesionet që lidhet me drejtimet profesionale të institucionit;

b) në rastet kur diploma Master shkencor (ose e barasvlershme me të) nuk përputhet me profesionin që lidhet me drejtimet profesionale të institucionit, kandidati duhet të ketë të paktën formim të mesëm profesional për një nga profesionet që lidhet me drejtimet profesionale të institucionit;

c) të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune ose eksperiencë si ekspert në fushën e AFP-së;

d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

III. Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit përmban këtë dokumentacion:

a) CV-në (jetëshkrimi), e cila plotësohet sipas udhëzimit bashkëngjitur;

b) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;

c) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

d) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

e) vërtetim të gjendjes gjyqësore;



f) dy rekomandime nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është sipas njoftimit të shpalljes së vendit të lirë, por jo më pak se 15 ditë nga data e shpalljes së vendit të lirë.

#### IV. Komisioni i vlerësimit

1. Pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ngrihet Komisioni i vlerësimit (Komisioni) me këtë përbërje:

a) një përfaqësues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë MMSR-së;

b) një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të AFP-së, pranë MMSR-së;

c) një përfaqësues i bordit (i autorizuar nga kryetari i bordit) të institucionit publik të AFP-së.

2. Fillimisht anëtarët e Komisionit nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Veprimtaria e Komisionit drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

#### V. Konkurrimi

1. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak, ku verifikohet nëse kandidatët kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar;

b) vlerësimi i detajuar i kandidatëve.

2. Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit, Komisioni rendit në një listë sipas rendit alfabetik kandidatët e kualifikuar.

3. Lista shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe në një vend të dukshëm të institucionit publik për të cilin zhvillohet konkurrimi.

4. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në adresën e tyre të e-mail-it, duke sqaruar dhe arsyet e moskualifikimit.

5. Brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Sekretarit të Përgjithshëm në MMSR. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

6. vlerësimi i detajuar i kandidatëve përfshin:

a) vlerësimin e jetëshkrimit dhe mbi bazën e dokumenteve të paraqitura (Komisioni plotëson tabelën sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

b) intervistën e strukturuar me gojë (komisioni plotëson tabelën sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi).

Totali i pikëve të vlerësimit është 100.

7. Vlerësimi e jetëshkrimit bëhet deri në 55 pikë, të ndara në:

a) deri në 15 pikë për arsimin e kërkuar:

i) 5 pikë për plotësimin e kërkesave;

ii) 10 pikë për tejkallim të kërkesave (gradë arsimore ose diplomë shtesë);

iii) 15 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave (gradë arsimore ose diploma shtesë në fushën e kërkuar, si dhe në fushën e drejtimit të institucionit);

b) deri në 15 pikë për eksperiencën e lidhur me fushën e AFP-së ose pozicionin:

i) 5 pikë për plotësimin e kërkesave;

ii) 10 pikë për tejkallim të kërkesave (nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin);

iii) 15 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin);

c) deri në 10 pikë për trajnimin e lidhur me fushën e AFP-së ose pozicionin:

i) 2 pikë për 1-3 trajnime, të lidhur me fushën e AFP-së ose pozicionin;

ii) 5 pikë për 4-5 trajnime, të lidhur me fushën e AFP-së ose pozicionin;

iii) 10 pikë për më shumë se 5 trajnime të lidhur me fushën ose pozicionin.

ç) deri në 15 pikë për botime në fushën në AFP-së dhe drejtimit:

i) 5 pikë për botimin e një teksti shkollor për lëndët teorike profesionale ose të çështjeve të tjera të sistemit të AFP-së ose për drejtimin e institucioneve;

ii) 10 pikë për botimin e një teksti shkollor për lëndët teorike profesionale dhe një botim për çështje të tjera të sistemit të AFP-së ose për drejtimin e institucioneve;

iii) 15 pikë për tejkallim të numrit të botimeve të parashikuara në dy paragrafët e mësipërm.



8. Pikët totale për intervistën me gojë janë 45, kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen, për:

a) legjislacionin e arsimit parauniversitar dhe të AFP-së (15 pikë);

b) vlerësimin e sjelljes në situata të ndryshme në lidhje me menaxhimin e stafit (10 pikë);

c) njohuritë, aftësitë teknike dhe kompetencën në lidhje me pozicionin e punës (10 pikë);

d) perspektivën e prezantuar prej tyre për sa u përket zhvillimit dhe miradministrimit të institucionit publik ofrues të AFP-së (10 pikë).

9. Komisioni bën vlerësimin përfundimtar me pikë, sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

10. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr 60 pikë, Komisioni vendos përfundimin e fazës së vlerësimit pa asnjë kandidat fitues.

11. Në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë rihap procedurën brenda 3 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të Komisionit.

VI. Përzgjedhja dhe emërimi i kandidatit për drejtues

1. Komisioni i vlerësimit i paraqet ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë raport me shkrim mbi vlerësimin e përmbledhur për kandidatët dhe procesin në përgjithësi.

2. Ministri pasi shqyrton raportin e Komisionit, shpall fitues kandidatin që është renditur i pari.

3. Shpallja e fituesit bëhet në të njëjtën mënyrë dhe vend si njoftimi i vendit të lirë.

4. Rezultatet e vlerësimit individual u njoftohen kandidatëve, sipas kërkesës së këtyre të fundit.

5. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim për rezultatit e pikëve, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MMSR-së, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

6. Emërimi i drejtuesve të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional bëhet nga ministri.

VII. Lirimi nga detyra i drejtorit të institucionit të AFP-së

1. Marrëdhënia e punës së drejtorit të institucionit të ofrues të AFP-së përfundon:

a) me dorëheqjen e motivuar të tij;

b) kur deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

c) kur përfiton të drejtën për pensionin e pleqërisë;

d) kur ndaj tij jepet masë disiplinore lirim nga detyra ose largim nga puna;

e) në rastin e konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ë) në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji.

2. Procedura e lirimit nga detyra të drejtorit të institucionit publik ofrues të AFP-së, mund të bëhet me iniciimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ose me propozimin e bordit të shkollës. Në këtë rast, drejtori ka të drejtë të dëgjohej nga bordi, para se ky i fundit t'i paraqesë ministrit kërkesën për lirim nga detyra të tij.

## KREU II

### PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE LIRIMIT NGA DETYRA TË NËNDREJTORIT TË SHKOLLAVE PROFESIONALE

I. Shpallja e vendit të lirë për nëndrejtor në shkollat profesionale publike

1. Nëse bordi i shkollës profesionale vlerëson për ngritje në detyrën e nëndrejtorit, një pjesëtar nga stafi mësimor, drejtori i shkollës i dërgon propozimin ministrit të MMSR-së. Në këtë rast, nëse kandidati plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, ministri miraton pa konkurrim propozimin.

2. Kur pika 1 nuk gjen zbatim, drejtori i shkollës njofton MMSR-në sapo vendi i një nëndrejtori është i lirë.

3. Drejtori i shkollës shpall njoftimin për vendin e lirë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të MMSR-së, si dhe në portalin e AFP-së. Shpallja bëhet edhe në një vend të dukshëm në hyrje të shkollës.

4. Dokumentet për aplikim janë të njëjta si në pikën 1/III, kreu I, dhe ato dorëzohen pranë drejtorisë së shkollës që ka vendin vakant.

5. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është sipas njoftimit të shpalljes së vendit të lirë, por jo më pak se 15 ditë nga data e shpalljes së vendit të lirë.

II. Kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për kandidatët për nëndrejtor

1. Kandidati për nëndrejtor, që mbulon kurrikulën e përgjithshme, në shkollat profesionale publike, duhet të plotësojë:

A. Kërkesa të përgjithshme:



- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

B. Kërkesa të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Master Shkencor në fushën e edukimit;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë punuar të paktën 3 vjet në një shkollë profesionale;
- d) të jetë vlerësuar të paktën “Mirë” në provimin e kualifikimit;
- e) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Kandidati për nëndrejtor, që mbulon kurrikulën profesionale, në shkollat profesionale publike, duhet të plotësojë:

A. Kërkesa të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

B. Kërkesa të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Master Shkencor për një nga profesionet që lidhet me drejtimet profesionale të shkollës që aplikon;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë punuar të paktën 3 vjet në një shkollë profesionale;
- d) të jetë vlerësuar të paktën “Mirë” në provimin e kualifikimit;
- e) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Kandidati për nëndrejtor, që mbulon anën ekonomike, në shkollat profesionale publike, duhet të plotësojë:

A. Kërkesa të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

B. Kërkesa të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Master Shkencor në shkencat ekonomike;
- b) të ketë punuar të paktën 3 vjet në një shkollë profesionale ose në profesion në institucione të tjera publike/private;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

III. Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga:

- a) kryetari i bordit të shkollës profesionale (ose i autorizuar nga ai);
- b) drejtori i shkollës;
- c) një mësues me eksperiencë i shkollës profesionale.

2. Komisioni drejtohet nga kryetari i bordit.

3. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

4. Anëtarët e Komisionit nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

IV. Konkurrimi

1. Konkurrimi zhvillohet sipas pikave 1-11/V, kreu I.

2. Drejtori i shkollës, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, rihap procedurën brenda 3 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të Komisionit.

V. Përzgjedhja dhe emërimi i kandidatit për nëndrejtor

1. Komisioni i vlerësimit i paraqet drejtorit të shkollës raport me shkrim që përmban vlerësimin e përmbledhur për kandidatët dhe procesin në përgjithësi.

2. Drejtori i shkollës, pasi verifikon procedurën, i propozon ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kandidatin që është radhitur i pari me pikë, për ta emëruar në detyrën e nëndrejtorit të shkollës.

3. Shpallja e fituesit bëhet në të njëjtën mënyrë dhe vend si njoftimi i vendit të lirë.

4. Rezultatet e vlerësimit individual u njoftohen kandidatëve, sipas kërkesës së këtyre të fundit, kur ka përfunduar procesi i përzgjedhjes.

5. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim për rezultatit e pikëve pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MMSR-së, brenda 3 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

6. Nëndrejtori emërohet nga drejtori i shkollës pasi merr miratimin nga ministri i MMSR-së.

VI. Lirimi nga detyra i nëndrejtorit

1. Marrëdhënia e punës së nëndrejtorit të shkollave profesionale përfundon sipas përcaktimeve të pikës 1/VII, kreu I.

2. Procedura e lirimit nga detyra e nëndrejtorit të institucionit publik ofrues të AFP-së bëhet nga drejtori i institucionit, pasi merr miratimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Për drejtuesit aktualë, të emëruar para këtij udhëzimi, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mund të bëjë rikonfirmimin e emërimit të tyre në detyrë.

Udhëzimi nr. 11, datë 26.9.2014 “Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe lirimit nga detyra të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, shfuqizohet.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtorja e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore në MMSR dhe institucionet publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE  
RINISË  
**Erion Veliaj**

SHTOJCA 1

## CURRICULUM VITAE

EMRI MBIEMRI  
DATËLINDJA  
TEL.  
ADRESA E-MAIL  
ARSIMIMI  
GRADA/TITULLI SHKENCOR  
PUNËSIMI  
CERTIFIKATAT  
PRODUKTET PROFESIONALE  
PROJEKTE  
MASAT ADMINISTRATIVE

Firma \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

## UDHËZIME

### PLOTËSIMI I CURRICULUM VITAE

#### ARSIMIMI

Diploma (diplomat) e shkollës së lartë.

#### PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet, duke filluar nga i fundit deri te punësimi i parë.

Për çdo punësim shkruhet:

- Viti i fillimit dhe i mbarimit;

- Titulli i vendit të punës (nëndrejtor, drejtor, inxhinier, mësues i mekanikës etj.);

- Adresa e vendit të punës (shkolla publike profesionale “Kristoforidhi”, Elbasan).

P.sh.:

2008 -2014 Nëndrejtor i shkollës private profesionale “Drita”, Tiranë

1990- 2008 Inxhinier, kompania private “Shqiponja”, Durrës

2008 – 1997 Inxhinier pyjesh, Ndërmarrja Shtetërore e Gjellbërimit, Durrës

#### CERTIFIKATAT

- Certifikatat për gjuhët e huaja

- Certifikatat për pjesëmarrje në trajnime, të marra brenda ose jashtë vendit, për aspekte të biznesit, drejtimin e shkollave/qendrave profesionale, të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, zhvillimin e praktikave profesionale dhe të tjera që lidhen me detyrën e drejtorit të një institucioni publik të AFP-së.

- Certifikatat për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Fillohet me certifikatën më të fundit.

#### PRODUKTET PROFESIONALE

##### LIBRA

Librat ndahen në:

- Tekste shkollore për lëndët teorike profesionale;

- Libra për drejtimin e institucioneve ofruese të AFP-së;

- Libra për çështje të tjera të sistemit të AFP-së;

- Libra për aspekte të biznesit.

#### SHKRIME

Shkrimet ndahen në:

- Për drejtimin e institucioneve ofruese të AFP-së;

- Për çështje të tjera të sistemit të AFP-së;

- Për aspekte të biznesit.





## KUMTESA PËR ASPEKTE TË SISTEMIT TË AFP-së

Përfshihen kumtesa në konferenca, simpoziume etj., të mbajtura brenda ose jashtë vendit për aspekte të sistemit të AFP-së ose të biznesit.

Për çdo referim tregohet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i kumtesës, emri i konferencës ose simpoziumit, vendi dhe viti i mbajtjes.

### PROJEKTE

Përfshihen pjesëmarrjet në projekte që kanë të bëjnë vetëm me drejtimin e institucionit ofrues të AFP-së ose për aspekte të tjera të sistemit të AFP-së.

Për secilin projekt përmendet titulli i projektit, organizmi që ka mbështetur realizimin e projektit, viti (vitet) kur është zhvilluar projekti, roli në projekt.

### VINI RE!

- Për certifikatat paraqiten kopjet e tyre.
- Për librat paraqitet kopja e ballinës.
- Për shkrimet paraqiten kopje të faqes së parë.
- Për kumtesat paraqitet kopja e faqes së parë.
- Për rekomandimet referohuni në udhëzimet më poshtë.

### REKOMANDIMET

Një rekomandim zë jo më shumë se gjysmë faqe.

Rekomandimi përshkruan dy aspekte të veprimtarisë profesionale të aplikuesit, duke përdorur fjalët “mjaftueshëm”, “mirë” ose “shumë mirë”. Këto aspekte janë:

- Etika profesionale dhe sjellja në marrëdhëniet e punës.
- Arritjet profesionale.

Rekomanduesi mund të shkruajë ndonjë ngjarje të spikatur në karrierën e aplikuesin.

## SHTOJCA 2 DEKLARATË

Unë i nënshkruari/e nënshkruara \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_

kryetarit/anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, deklaroj sa më poshtë:

1. Aplikuesi për drejtor/nëndrejtor i institucionit publik të AFP-së nuk është pjesëtar i familjes sime dhe as i afërm (prind, bashkëshort/bashkëshorte, fëmijë, vëlla, motër).

2. Nuk do të ndikohem për arsye personale në kryerjen e detyrave që parashikon për mua udhëzimi “Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të drejtuesve të institucionit publik ofrues i arsimit dhe formimit profesional” (më tutje “udhëzimi”).

3. Nuk do të ndikohem nga persona të tjerë në kryerjen së detyrave që parashikon për mua udhëzimi.

4. Nuk do të pranoj çfarëdolloj përfitimi vetjak ose për familjen dhe të afërmit e mi në kryerjen së detyrave që parashikon për mua udhëzimi.

5. Nuk do të nxjerr informacione rreth vendimeve ose të dhënave që udhëzimi parashikon, të cilat nuk janë shpallur zyrtarisht.

6. Nuk do të deklarohej në media për vendimet e Komisionit të Vlerësimit pa qenë i autorizuar.

7. Nuk do të paraqes pikëpamjet e mia vetjake si qëndrime të Komisionit të Vlerësimit.

Për sa më sipër, mbaj përgjegjësi të plotë për këto deklarime:

**Emri, mbiemri** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data e nënshkrimit të deklaratës:** \_\_\_\_\_

## SHTOJCA 3

### TABELA E PIKËVE PËR APLIKUESIN, VLERESIMI I DOKUMENTEVE

(Emri, mbiemri) \_\_\_\_\_

Kriteret	Vlerësuesi i parë	Vlerësuesi i dytë	Vlerësuesi i tretë			Shuma e pikëve
Arsimi, deri në 15 pikë (gradë arsimore shtesë ose diplomë shtesë në fushën e AFP-së ose menaxhimit)						



Përvoja në punë, deri 15 pikë (më shumë se 3 vjet në fushën e AFP-së ose drejtim)						
Kualifikimet e trajnime në lidhje me fushën e AFP-së dhe menaxhim, deri në 10						
Botime (tekste shkollore, botime në fushën e AFP-së), deri në 15 pikë						
Shuma (55 pikë)						
Llogaritja (total/5)						

**SHTOJCA 4**  
**TABELA E PIKËVE PËR APLIKUESIN, VLERËSIMI I INTERVISTËS**

(Emri, mbiemri) \_\_\_\_\_

Pyetjet	Vlerësuesi i parë	Vlerësuesi i dytë	Vlerësuesi i tretë			Shuma e pikëve
1 (5 pikë)						
2 (10 pikë)						
3 (10 pikë)						
4 (10 pikë)						
5 (10 pikë)						
Shuma						
Llogaritja (total/5)						

**SHTOJCA NR. 5**  
**REZULTATI PËRFUNDIMTAR I KANDIDATËVE PËR POZICIONIN**

Emri, mbiemri (renditja e kandidatëve sipas shumës së pikëve totale)	Pikët për dokumentet e dorëzuara (maksimalja 55 pikë)	Pikët për intervistën e strukturuar (maksimalja 45 pike)	Shuma e pikëve totale (maksimalja 100)

Komisioni i vlerësimit

1. \_\_\_\_\_ kryetar
2. \_\_\_\_\_ anëtar
3. \_\_\_\_\_ anëtar



**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 4.3.2015**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOXHERI  
ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC “KOXHERRAJ”,  
ME FUQI TOTALE 0.62 MW**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Koxherri Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Koxherra”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Dokumentacioni i përgjithshëm

Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Të dhënat teknike

Neni 9, pika 4.1.1 “Të dhëna specifike për HEC”

Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.2 “Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin”

Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3 “Dokumentacioni teknik dhe grafik”

Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.4 “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”

Është plotësuar tërësisht

Neni 9, pika 4.1.5 “Leje nga institucione të tjera”

Është plotësuar tërësisht.

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Koxherra”, me fuqi totale 0.62 MW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**  
**Nr. 29, datë 4.3.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË  
LICENCIMIT TË SHOQËRISË  
“KOXHERRI ENERGJI” SHPK, NË  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Koxherri Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së



Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2, është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3 “Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar”.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Koxherri Energji” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 30, datë 4.3.2015

### PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ELECTRAL” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për

procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Electral” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Electral” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar korrekt.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Electral” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 31, datë 4.3.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË  
LICENCIMIT TË SHOQËRISË  
“ELECTRAL” SHPK, NË AKTIVITETIN E  
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9; 13, pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Electral” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Electral” sh.p.k., plotëson plotësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal i plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Electral” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 32, datë 4.3.2015**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“AYEN AS ENERGJI” SHA NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et  
“GOJAN”, “GJEGJAN”, “PESHQESH”  
DHE “FANGU”, ME FUQI 110.54 MW**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS Energji” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”, me fuqi totale 110.54 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS Energji” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në nenin 9, pika 1 (formatin e aplikimit), nenin 9, pika 2 (dokumentacionin juridik, administrator



dhe pronësor), nenin 9, pika 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës, të përcaktuara në nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC), neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin), neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik), neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), neni 9, pika 4.1.5

(leje nga institucione të tjera) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AYEN AS Energji” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, me fuqi 12,25 MW, “Gjegjan”, me fuqi 6,55 MW, “Peshqesh”, me fuqi 27,94 MW dhe “Fangu”, me fuqi 63,8 MW, me fuqi totale 110.54 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtorja e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 33, datë 4.3.2015

### PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Alpiq Energy Albania”

sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2, është plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata që personi përgjegjës nuk është i përfshirë në një proces penal.)

- Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht:

(Bilanci financiar është paraqitur në gjuhën angleze).

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 10 dhe nenit 11, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 34, datë 4.3.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË  
 LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALPIQ  
 ENERGY ALBANIA” SHPK, NË  
 AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË  
 KUALIFIKUAR TË ENERGJISË  
 ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31, 8, pika 2, germa “a”; 9; 13, pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4, dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f” 8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Dokumentacioni i përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata që personi përgjegjës nuk është i përfshirë në një proces penal.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

(Bilanci financiar është paraqitur në gjuhën angleze.)

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
 Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 35, datë 4.3.2015**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
 “DEVOLL HIDROPOWER” SHA NË  
 AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
 ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hidropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:



Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Devoll Hidropower” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 36, datë 4.3.2015

### PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DEVOLL HIDROPOWER” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4; dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008,

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hidropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gërmat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Devoll Hidropower” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1180, datë 12.12.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Petraq Kumati (Çami), i biri i Vasilit dhe i Sofies, i datëlindjes 20.5.1937, lindur në Mangalem, Berat.





## **KËRKESE**

Shtetasi Adriatik Memushaj, i datëlindjes 25.9.1974, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Gramoz Çuman Memushaj.

**KËRKUESI**  
**Adriatik Memushaj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë